

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	214-25-7556-1-2-1
------------------	--------------------------

Titulli: Blerja e pajisjeve per brigaden e zjarrfikësave (Gjenerator, motorrësharrë, kompresor, shkallë, etj.)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PROGLOBAL SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

DARDANI, 28 NENTORI, LI-2, Lok. 129

(Vendi)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+38344148645

(Numri Telefonit)

Latif Imeri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@proglobal-ks.com

(Adresa elektronike)

07.11.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Me datën 20.08.2025 - publikimi “Njoftimit për Kontrate” ne sistemin elektronik të prokurimit.
- Me datën 10.09.2025 - B12 Proces verbali i hapjes së Tenderëve
- Me datën 20.10.2025 - Vendimi i AK dhe Letra Standarde
- Me datën 24.10.2025 – Kërkesa për rishqyrtim
- Me datën 29.10.2025 – Vendimi i AK-së refuzimi i kërkesës.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e ofertave me datën 10.09.2024.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Operatori Ekonomik ankues "PROGLOBAL" shpk – Prishtine, me datën 24.10.2025, ka parashtruar kerkese për ri shqyrtim te vendmit te AK – Ministria e Punëve te Brendeshme, gjegjesisht kundër Vendimit te AK-se, arsyetimit te eleminimit te ofertës sonë dhe propozimit për dhenien e kontrates ndërsa AK - MPB, me vendmin e datës 29.10.2025, refuzon kerkesen tone dhe le ne fuqi vendimin e saje ani pse te kunderligjeshem.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji nr. 04/L-042, për prokurim publik.

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 27 Dosja e Tenderit
- Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Rregullorja me nr 001/2022, per Prokuim Publik

- Neni 17 Dosja e Tenderit
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 97 Shkeljet e rënda

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Grupi i OE-ve ankues “Proglobal” SH.P.K. & “Vulcan” SH.P.K, bazuar ne dispozitat ligjore te ligjit për prokurim publik gjegjesisht nenit 108/A te LPP-se, 24.10.2025, përmes kerkeses për Rishqyrtim ka ushtruar te drejten e kontestimit te vendimit te AK-se, përkatësisht eliminimin e ofertës sonë, ku përmes letres standarde te datës 20.10.2025, është potencuar se oferta jone është e pa pergjegjeshme si me poshte:

- *Nuk është dorëzuar Deklaratë nen Betim apo nuk është plotësuar si duhet, ne deklaraten nen betim është dhënë emri dhe adresa e kompanisë Pastor Kosova shpk, ndërsa është vulosur me vulën e Vulcn shpk.*
- *Marreveshja e konzorciumit nuk eshteplotësuar siç është kerkuar ne aneksin 7 te dosjes se tenderit. Ne marreveshje ne daqen e pare figuron emri i një kompanie me te cilen jeni ne konzorcium, ndërsa është neshkruar dhe vulosur nga një kompani tjetër, gjithashtu nuk janë thene perqindjet e pjesemarrjes dhe*
- *Ne dosjen e tendeit aneksi 1, tek specififikimet teknike tek pozicioni 1 përveç tjerash është kerkuar qe aparati i dioksid karbonit 10 kg – AKZ te jete pajisur me EPDM me gjatesi prej L=500cm, nuk është ofruar gjatesia e gypit dhe gjithashtu nuk ka evidence qe është i certifikuar sipas 99/36/EC dhe EN 1964-1.*

Ne si kompani kemi prezantuar prova dhe fakte konkrete për veprime kundërligjore, pavaresisht kesaje AK – MPB, me vendimin e saje te datës 29.10.2025, ka refuzuar kerkesen tone dhe ka lene ne fuqi vendmin e saje, prandaj bazuar ne dispozitat e nenit 109 te LPP-se paraqesim këtë ankese:

Pretendimi ankimor 1.

Sa i përket arsytimit te pare te eleminimit kompania Pastor Kosova shpk anetari i grupit e ka ndërruar emrin në Vulcan SHPK, dhe atë **me date 13.02.2024**, si rrjedhoj e kesaje numri unik Identifikues i “Vulcan SH.P.K”, është **810484775**, pra kemi te bëjmë me te njejtin subjekt por qe ka ndryshuar vetëm emri.

Ndryshimi i emrit nga "Pastor Kosova shpk" në "Vulcan SHPK" ka ndodhur para datës së publikimit te njoftimit për kontrate dhe para hapjes se ofertave, dhe identiteti i subjekti gjegjesisht NUI: 810484775, ka mbetur i njëjtë.

Pra, vulosja me emrin e ri në një dokument që ende përdor emrin e vjetër (Pastor Kosova), mbështetur në deklaraten e ndryshimit të emrit, nuk duhet dhe nuk mund te konsideroj si te papërgjegjshme kompanine tone.

Kjo dëshmi është e bashkangjitur në ofertën tonë – certifikata e biznesit dhe deklarata për Ndryshim te emrit te biznesit.

Qeshtja tjetër dhe pika tjetër e eleminimit - përdorimi i emrit të vjetër "Pastor Kosova shpk" në Deklaratën nën betim, por i vulosur dhe identifikuar me vulën e emrit të ri “Vulcan SH.P.K., nuk mund te perdoret si arsytim i eleminimit te ofertës sonë pasi qe kemi te bëjmë me subjekt te njëjtë veq se i është ndryshuar emri, ku për këtë qeshtje ne si kompani ne oferte kemi prezantuar prova dhe fakte se kemi te bëjmë me te njejtin subjekt me te njejtin pronare dhe me te njejtin Numër Unik Identifikues 810484775

- Prove: Deklarata e nderrimit te emrit te biznesit.

VULCAN shpk
Adresa: 41, 28 nentori, LI-2, Lok. 3/1
10000, Prishtine

DEKLARATE
Per
Ndryshimin e Emrit te Biznesit

Per tenderin me,
Numri i Prokurimit: **214-25-7556-1-2-1**
Titulli: **“Furnizim me aparate për fikjen e zjarrit në ndërtesat qeveritare QPD,
QRA në Komuna”**

Deklarojme se nga data 13.02.2024 eshte bere ndryshimi i Emrit te Biznesit
Nga Pastor shpk ne VULCAN SHPK

Prishtine
10.09.2025

VULCAN sh.p.k,
Latif Imeri



Për veprime te tilla dhe për procedura tjera edhe OSHP, ka te nxjerra me dhjetra vendime te cilat janë publike ne ueb faqe dhe qeshtjen e ndryshimit te emrit te biznesit nuk është konsideruar si baze për eliminimin e ndonje oferte te caktuar.

Prove: Vendimi i datës 02/11/2023, me nr. OSHP: 2023/0707
Citat nga vendmi i OSHP-se me nr te larte pershkruar:

OE i rekomanduar për kontratë në bazë dokumentacionit të ofertës se tij ka dorëzuar certifikatën e biznesit me numër unik identifikues 812927549 i datës 23.03.2023 e ndërron tipin e statusit duke kaluar nga Biznesi individual me emër të biznesit ‘Shpend N. Belegu B.I.’ me emër tregtar D.P.SH “PRO –PRINT” kalon ne status në “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” me emër te biznesit “PRO PRINT” sh.p.k., dhe është vazhdim i biznesit te mëhershëm ashtu siç është shënuar ne faqen 2 të certifikatës se biznesit. Nga kjo shihet se me rastin e ndërrimit te statusit te kompanisë me emër tregtar “PRP PRINT” sh.p.k asnjëherë nuk është ndryshuar që do të thotë që në informata mbi biznesin faqe 2 të certifikatës citoj” dhe eshte vazhdim i biznesit te mëhershëm.”

Pra AK – MPB, me arsyetim te tille te eliminimit ka shkelur parimet bazë të prokurimit publik, veçanërisht nenin 6 dhe 7 te LPP-se, përkatësisht nenin 72 Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë dhe Nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të LPP-së, duke anashkaluar mundësinë e sqarimit të tenderit dhe vleresimin real te ofertave ashtu siç obligohet edhe me dispozitat e nenit 10 i Rregullores së Prokurimit.

Pavarësisht mospërputhjes formale, subjekti është i njëjtë, fakt i dëshmuar me Numrin Unik Identifikues: **810484775 dhe Deklaratën për Ndërrim të Emrit të Biznesit të datës 10.09.2025**, e cila qartëson se ndryshimi ka ndodhur para datës së tenderit më 13.02.2024, rrjedhimisht, ekzistenca e subjektit të ri dhe NUI-t të njëjtë ishte e fiksuar para datës se hapjes se ofertave siç lejohet dhe percaktohet me nenin 72.3 të LPP, dhe refuzimi pa kërkuar sqarim është shkelje e rëndë e parimit të trajtimit të barabartë Neni 7, dhe e përcaktuar edhe me nenin 97 të Rregullores nr n 001/2022.

Pretendimi ankimre 2.

Sa i përket arsytimit të dyte të eliminimit lidhur me mospërputhje në emrat dhe mosplotësim të përqindjeve të pjesëmarrjes, perseri nuk gjene mbeshtetje ligjore, pasi që anëtari i konzorciumit, Vulcan SH.P.K. tani me ish Pastor Kosova sh.p.k , si dhe lideri i grupit “Proglobal SH.P.K., përfaqësohen nga i njëjti Drejtor, z. Imeri, dhe me këtë konfirmohet dhe vërtetohet se autorizimet janë të qarta dhe të plota për këtë procedurë të prokurimit.

Pra mos-plotësimi i përqindjeve të pjesëmarrjes sipas pikes 5 e Aneksit 7, nuk cenon përgjegjësinë ligjore të përbashkët të konzorciumit, të cilën ne e kemi konfirmuar në nenin 3 të marrëveshjes së krijimit të grupit – konzorciumit, si rrjedhojë e kesaje AK - MPB, pergjate procesit të vlerësimit të ofertave në rastin e dilemave ka qene i obliguar që të aplikojë dispozitat e nenit 59 dhe 72, të LPP-se dhe të kërkojë sqarime shtese për këtë qeshtje, pasi që kjo nuk konsiderohet ndryshim thelbesore apo material i ofertës.

Deklarata e krijimit të grupit – konzorciumit i plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe si e tille është legjitime ashtu siç kërkohej me nenin 26 të rregullores me nr. 001/2022, për prokurim publik gjegjësisht është përcaktuar përgjegjësia e ***të gjithë anëtarët e grupit që janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, është nënshkruar nga secili nga anëtarët***, që konfirmon pjesëmarrjen në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit dhe është autorizuar partneri apo udhëheqësi që të veprojë në emër të grupit.

- **Prove:** deklarata e krijimit të grupit pjesë e ofertës.

Pretendimi ankimre 3.

Pavarësisht faktit se AK – MPB, hapjen e ofertave e ka realizuar me datën 10.09.2025, ku një gjë e tille konfirmohet me procesverbalin e hapjes së ofertave nuk janë ndërmarrë veprime ligjore për të egzaminuar dhe krahasuar ofertat apo për të kërkuar sqarime shtese ndaj ofertës sonë në atë mënyrë që të zbatohen në teresi rregullat ligjore, ndersa ka publikuar vendimin – formualrin B58, me datën 20.10.2025, perkatesisht për të vlerësuar ofertat kunderligjeshme i janë dasht plot 40 dite perderisa **neni 40, i rregullores me nr 001/2022, paragrafi 3, nuk lejon që vlerësimi dhe ekzaminimi i ofertave të kalojë periudhën përtej 30 diteve.**

Neni 40.3, përcakton:

Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave

Pra Vlerësimi ka zgjatur mbi 40 ditë, respektivisht me 10.09.2025 janë hapur ofertat, ndërsa me datën 20.10.2025 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK-se, duke tejkaluar afatin maksimal prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 40.3 të Rregullores nr. 001/2022, për Prokurim Publik. Kjo tregon shkelje të parimit të Ekonomicitetit dhe Efikasitetit nga neni Neni 6 i LPP dhe neglizhencë në procesin e vlerësimit, duke përfunduar me eliminim të kundërligjshëm të kompanisë sone.

Pretendimi ankimre 4.

Arsyetimi tjetër i eliminimit lidhur me aneksin 1 të Specifikave teknike – pozicioni 1 përveq tjerash është kërkuar që aparati me dioksid karboni 10kg AKZ të jetë i pajisur me tub EPDM me gjatësi L=500cm (5m), nuk është ofruar gjatësia e gypit dhe gjithashtu nuk ka evidence që është i certifikuar sipas 99/36/EC dhe EN 1964-1, **NUK QENDRON**.

Ne si grup i OE-ve me oferte kemi dorëzuar katalogun për aparat zjarrfikës CO2-10kg. Jo gjithë katalogu përmbanë të gjitha detajet që mund të përkrahën në Aneksi 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme për një aktivitet të prokurimit. Për arsye se AK zakonisht Aneksin 1 e përkrahë / përshtatë për prodhues të caktuar siç është vepruar edhe në këtë rast ku AK ka përkrahë specifikat teknike të prodhuesit MOBIAK Greqi.

AK bazuar në LPP me sqarime shtesë mund të merren informacionet për aparat zjarrfikës CO2-10kg.

Sqarim

Aparati zjarrfikës me dioksid karboni, tip CO2-10kg të ofertuar, **është me tub EPDM me gjatësi L=500cm (5m).**

Gjithashtu është i certifikuar sipas 99/36/EC dhe EN 1964-1.

Prova 1 –Tubi për CO2-10kg me gjatësi 5m EPDM (faqe 5)

Prova 2 – Certifikata e Konformitetit të certifikuar sipas 99/36/EC dhe EN 1964-1

Prandaj AK me vlerësim të tillë të ofertave, ka shkelur parimet bazike të prokurimit publik.

Neni 10, i rregullores me nr. 001/2022, përcakton:

Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 *Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së*

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon certifikata	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon licenca	Mund të kërkohen informata sqaruese	66

Dispozita e sipër përkrahë dhe e prezantuar sipas paragrafit 1, AK dhe secilin AK, tjetër e obligon që të ndermerren veprime ligjore për sqarim dhe plotësim, me të kjo si AK – Zyrtarin përgjegjës dhe anëtarët e komisionit vlerësues nuk mundeson që të eliminohet oferta jone me arsyetime të pa qena, meqenese jemi të përgjegjshëm.

Në ofertë ne si kompani kemi dorëzuar katalogun për aparat zjarrfikës dhe mungesa e detajeve specifike në katalog, nuk mund të jenë arsye për eliminim, pa kërkuar sqarime.

Neni 10 i Rregullores me nr 001/2022 dhe nenet 59 dhe 72 të LPP, lejojnë dhe rekomandojnë që AK përkatës të kërkojë informata sqaruese kur mungojnë certifikatat ose licencat. AK e ka për detyrë të kërkonte sqarim, dhe jo të eliminonte, veçanërisht kur pretendon se aparati është i certifikuar dhe është me gyp 5m.

Pretendimi ankimre 5.

Kriter ne DT - Kriteret e dhenies, 30.1 eshte – Tenderi i pergjegjshem cmimin me te ulte

AK ka vepruar ne kundershtim me kriteret e percaktuara te FDT per dhenie te kontrates, me rregullat ligjore dhe parimet e prokurimit pasi qe nuk ka përdorur mundësinë e sqarimit, **por ka favorizuar operatorin e rekomanduar, i cili ka ofertë mbi 40% më të lartë se sa oferta jone** dhe si e tille është oferte abuzuese dhe me çmim ekstrem te larte (jonormalisht te larte). Duke abuzuar me parane publike

Oferta e Konzorciumit: Proglobal shpk & Vulcan shpk eshte: **42668.46 Euro**

Oferta e OE te propozuar per kontrate Albkos shpk eshte: **58576.00Euro**

Dallimi ne cmime 15907.54 Euro (rrethe 40%).

Te gjitha faktet e sipër prezantuara, tregojne shkelje ligjore, favorizim përkatësisht diskriminim te kompanise sonë meqe jemi te pergjegjshem, prandaj kërkojmë nga OSHP dhe zyrtaret përgjegjës te saje te ndermarrin veprime ligjore, ti trajtojne te gjitha pretendimet tona ankimore ashtu siç percaktohet me nenin 105 dhe 113 te LPP-se, ne atë mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerre këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet,** e bazuar ankesa e OE “Proglobal” shpk
- II. Anulohet,** njoftimi mbi vendimin e KA-se i daes 20.10.2025, si i kunderligjeshem dhe lënda kthehet ne **Ri-vlereim.**
- III. Kualifikohet,** si e pergjegjeshme oferta e OE ankues OE “Proglobal” shpk
- IV. Lejohet,** kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankeses.

Ne si kompani me doemos do ti ndermarrim edhe veprimet tjera ligjore pasi qe haptazi AK-MPB, ka ndermarr veprime kundërligjore dhe ka eliminuar kompanine tone kunderligjeshem, perkatesisht eshte favorizuar kompania e rekomanduar e cila permbane cmimin diku rreth 40% me te larte se oferta jone kjo tregon për abuzim me parane publike.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme por deri me tani te pa kalkuluara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*